



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
DREJTORIA E MENAXHIMIT TE PYJEVE E KULLOTAVE DHE BUJQESISE

Nr. 955 prot

Pukë, më 16 / 04 / 2024

PROJEKT-VENDIM
NR. _____, Date _____, 2024

Per korrigjimin e vendimin e keshillit bashkiak Nr.64 date 23/10/2019

Per miratimin e heqjes nga fondi pyjore publik te siperfaqjes 0.15 ha qe do perdoret per ndertimin e HEC Gomsiqe e Eperme bashkia Puke ,

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënplikat 1.1 shkronja "b" dhe 1.2, shkronjat "a" dhe "c", nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike", Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ne Ligjin nr.43 date 30.04.2015 "Per sektorin e energjise elektrike." i ndryshuar , ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te Bashkive te fondit pyjor e kullisor publik.", V.K.M-ve nr 888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhenjes ne perdorimi dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit ,procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimin e siperfaqeve dhe paksimin ne volum nga fondi pyjor kombetar apa zgjerimin e tyre; VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 "Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore 1374, date 10.10.2008 "Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor" Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullisor publik",si dhe Shkresen Nr.374 prot.date 15.01.2024 te Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit Drejtoria e Pergjithshme per Zhvillimin e Mjedisit,Drejtoria e Mjedisit dhe Pyjeve ku kerkohet korrigjimi i vendimit.

Me propozim te Kryetarit te Bashkise Keshilli Bashkiak :

VENDOSI:

1. Te miratoje korrigjimin ne piken 2 te vendimin Nr 64 date 23/10/2019 si me poshte:
Ne piken 2 te vendimit nr.64 date 23/10/2023 behet korrigjimi sipas raportit tekniko-ekonomik duke pasqyruar parcelen nr.110/a ne ekonomine pyjore Gomsiqe ne pronesi te Bashkise Puke"

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Drejtori e menagjimit te Pyjet e kullotat,dhe Bujqesine.
3. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6,e ligjit nr 139/2015"Per veteqeverisjen vendore"

HARTUESI

Edmond PRENDI

JURISTI

Aida SINANI

KRYETARI

Rrok DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
STRUKTURA PERGJEGJESE PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 855/prot

Pukë, më 16.04.2024

RELACION

Per korrrigjimin e vendimin e keshillit bashkiak Nr.64 date 23/10/2019

Per miratimin e heqjes nga fondi pyjore publik te siperfaqjes 0.15 ha qe do perdoret per ndertimin e HEC Gomsiqe e Eperme bashkia Puke .

DREJTUAR :Keshillit Bashkiak Puke

Te nderuar keshilltare

Administrimi I fondit pyjore kullusore ne Bashkine Puke eshte nje nga funksionet I percaktuar ne nenin 27 te ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ku ne piken 5 te ketij neni percaktohen funksionet e Bashkive ne fushen e Bujqesise zhvillimit rural pyjeve dhe kullotave publike ,natyres dhe biodiversitetit .Bashkite jane pergjegjese per kryerjen e ketyre funksioneve:pika 5 administrimi I fondit pyjore dhe kullusor eshte ligji nr 57/2020 si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij ,ne zbatim te nenave 15 dhe 17 te ketij ligji ka dale udhezimi I Ministrise Mjedisit nr 01 date 09.06.2016"Per caktimin e kriterëve per dhenje/heqje ne perdorim te fondit pyjore.

Bazuar ne udhezimin e mesipermi si dhe ne Shkresen Nr.374 prot.date 15.01.2024 te Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit Drejtoria e Pergjithshme per Zhvillimin e Mjedisit,Drejtoria e Mjedisit dhe Pyjeve ku kerkohet korrrigjimi i vendimit.

Ne vendimin keshillit bashkiak Nr.64 date 23/10/2019 ne piken 1 te vendimit shprehet dakortesin per heqjen nga fondi te siperfaqjes 0.15 ha

Ne piken 2 te vendimit pasqyrohen parcela nr.30/a dhe 112 me siperfaqje 0.1 ha duke qene se ne piken Nr. 1 te vendimit eshte dhene dakortesia per heqjen nga fondi pyjor i siperfaqjes

0.15 ha kjo shpjegon se mungon parcela nr.110/a e cila eshte e pasqyruar edhe ne tabelen nr.4 te raportin teknkiko-ekonomik te hartuar nga struktura e pyjeve theksojine se mos pasqyrimi

ne piken 2 te vendimi te parces 110/a eshte si rezultat gabimit prandaj kerkojme nga antaret e keshillit te miratojne saktesimin ne piken 2 te vendimit te pasqyroje parcelen 110/a.

Duke ju falenderuar ju ftojme ne miratimin e projekt vendimit per korrigjimin e pikes 2 te vendimi te pasqyrohet parcela nr 110/a ne ekonomin pyjore Gomsiqe

Hartuesit

Edmond PRENDI

300 sime

kon. me. 11.11.2019
o/h. Nr. 1192/1 prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

2453/2
17.11.2019

Shkodër, më 11.11.2019

LËNDA: Mbi vendimin nr. 64, datë 23.10.2019 të Këshillit të Bashkisë Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e" dhe shkronja "e/1", neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 9693, dt. 19.03.2007 "Për fondin kullësor, i ndryshuar, neni 17, të VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", pika 50 shtojca 48, të VKM nr. 391, dt. 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", të ndryshuar, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar, pika 5, shkronja "ç", të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, dt. 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", pika 22, shkronja "f", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neni 48 dhe 49, të Miratimit Paraprak të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 502/2, datë 15.01.2019, shqyrtoi **VKB Pukë nr. 64, datë 23.10.2019 "Për miratimin për heqjen dhe dhënien në përdorim nga fondi pyjor publik të sipërfaqes 0.15 ha që do të përdoret për ndërtimin e HEC "Gomsiqe e Eperme", Bashkia Pukë"**.

Për sa trajtuar, Prefekti për procedim të mëtejshëm në respekt të neneve 7, 12, 13 ligjit nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i përditësuar dhe meqenëse objekt trajtimi është ndërtim h/c, paraprakisht kërkohet që subjekti duhet të jetë i pajisur me leje nga organi përgjegjës (këshilli i basenit ujq Drin Bunë) për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

Vendimarrja duhet të shoqërohet nga seancat e konsultimit(përgjegjësi e KB) në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Cesk **MILLIJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2458 prot:

Pukë, më 23.10.2019

VENDIM

Nr. 64, datë 23/10/2019

Per miratimin per heqje nga fondi pyjor publik te siperfaqes 0.15 ha qe do te perdoret per ndertimin e "Hec Gomsiqe e Eperme" Bashkia Puke.

Keshilli i Bashkise Puke ne mbledhjen e radhes te dates 23.10.2019 ne zbatim te nenit 8 pika 2, neni 9, pika 1,2, germa "a", neni 54, germa "e", neni 55 pika 4 te ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per vetegeverisjen Vendore"; Ligji nr 48/2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9385, date 04.05.2005" Per pyjet dhe sherbimin pyjore "I ndryshuar: ne baze te VKM nr 591 date 9.10.2018 Per disa ndryshime ne vendimin nr 1353 date 10.10.2008 "Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses, mbajtjes dhe paraqitjes se dekuamentacionit teknik, si dhe te kriterave e te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor Pika "ç) V.K.M Nr 433, date 08.06.2016" Per transferimin sipas listes se inventarit te pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht ne administrimin e Ministrise se Mjedisit dhe ish komunave/Bashkive ne pronesi te Bashkive, Udhezimin te Ministrise se Mjedisit nr. 01 date 09.06.2016 "Per rregullat , procedurat e kerkimit , te shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenje ne perdorim te fondit pyjor publik" dhe kerkeses se shoqerise "sima-com" Sh.p.k S "Roland" Sh.p.k nr.41 prot. date 19.06.2019 nga na e struktures pergjegjese per pyje; Me propozim te kryetarit Bashkise: Keshilli i Bashkise pas shqyrtimit me 9 (nente) vota pro:

V E N D O S I:

1. Miratimin e kerkeses per heqjen nga fondi pyjor te siperfaqes prej 0.15 ha- nga ana e Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit;
2. Siperfaqet qe do te hiqen nga fondi pyjor jane percaktuar ne raportin mbi studimin tekniko- ekonomik per dhenje ne perdorim/heqje nga fondi pyjore per ndertimine Hec Gomsiqe e Eperme, Parcela nr 30/a siperfaqja qe do te hiqet 0.05 ha. Pe nr. 112 siperfaqja qe do te hiqet 0.05 ha;

3. Per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor te zbatohet V.K.M nr 591 date 09.10.2018 Pika "ç";
4. Per vazhdimin e procedurave sipas përcaktimeve te Udhëzimit nr 2/2016 te Ministrise Mjedisit, ngarkohet seksioni i pyjeve dhe kullotave ne Bashkine Puke zyra kadastres pyjore.
5. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Sektori i zhvillimit rural, Seksioni pyjeve dhe kullotave;
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore".

Shpallur me datë 25.10.2019

SEKRETARE

Besmira **ALLAJ**



KRYETARI

Enver **SULEJMANI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
SEKSIONI PYJEVE-DHE KULLOTAVE

Nr. 995/2 prot:

Puke, me 30.12 2020

URDHËR
Nr. 350, Datë 30.12.2020

PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TEKNIKO EKONOMIK
DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNJE NË PËRDORIM NGA FONDI
PYJOR PUBLIK TË NJË GJATESIE 3.113 KM QË NUK NDRYSHOJNË
KATEGORINË E PËRDORIMIT NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË HEC
"GOMSIQË E EPERMË" SHOQËRISË "SIMA-COM" SH.P.K S "ROLAND" SH.P.K
BASHKINË PUKE

Në mbështetje të ligjit 139 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, të neneve 17 dhe 19 të ligjit numër 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar, të V.K.M nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe paraqitjen e kërkesës, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimi të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar, të Vendimit Paraprak nr. 502/2 prot date 15.01.2019 për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë nga ana e Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë dhe dhe shoqërisë "Shoqëria "SIMA-COM" Sh.p.k S "ROLAND" Sh.p.k., në Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit nr. 1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik,

URDHËROJ:

1. Vijimin e procedurave që duhet të ndjekë struktura përgjegjëse për pyjet në bashkinë Puke për dhënie në përdorim të një gjatesie 3.113 km në ngastrat/nëngastra 30/a,112, 110/a bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullor "Gomsiqe" dhe ngastrat/nëngastra 84/c,81/a,85/a,79/a,77,76.75 linje tensioni bëjnë pjesë në ekonominë pyjore "Gomsiqe"
2. "Shoqëria "SIMA-COM" Sh.p.k S "ROLAND" Sh.p.k duhet të rehabilitojë sipërfaqet objekt ndërtimi sipas planit të rehabilitimit dhe lejes mjedisore si dhe të pyllëzojë me drurë pyjorë, brenda vitit të parë, një sipërfaqe prej 3.92 ha dhe 3 fshin e sipërfaqes që do të hiqet nga fondit pyjor 0.45 sipas marrëveshjes me Bashkinë Puke .
3. Sekcioni i Pyjeve dhe Kullotave në bashkinë Puke, në prani të përfaqësuesve të "Shoqëria "SIMA-COM" Sh.p.k S "ROLAND" Sh.p.k:

a. shënojnë në terren poligonin me sipërfaqen pyjore objekt i përdorimit për ndërtime

infrastruktura të Hec-it "Gomsiqe e Eperme"

- b. bëjë vlerësimet në volum e vlerë për lëndën drusore dhe pasuritë e tjera pyjore që janë hequr gjatë kryerjes së punimeve dhe mbajë aktet përkatëse;
- c. monitorojë në vite detyrimet përkatëse dhe kryerjen e procedurave në terren për reabilitimin, pyllëzimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve në përdorim.
4. "Shoqëria "SIMA-COM" Sh.p.k & "ROLAND" Sh.p.k. të kryejë pagesat e menjëhershme në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Puke, sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar, me V.K.M nr 1064 date 22.12.2010 për lëndën drusore dhe pasuritë e tjera pyjore që janë hequr gjatë kryerjes së punimeve dhe tarifën e përdorimit për vitin e parë e në vijim.
5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bën regjistrimin e sipërfaqes pyjore publike të identifikuar sipas lidhjes 1 (një) të këtij vendimi, nga kategoria "Tokë e zënë pyjore" dhe e regjistron në kategorinë "Tokë e zënë, objekt i ndërtimit të godinës së Hec-it "Gomsiqe e eperme" shpk.
6. Ndryshimet në regjistrin kadastral për sipërfaqet pyjore objekt i ndërtimit të godinës së Hec-it, "Gomsiqe e Eperme" bëhen në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 4, datë 12.09.2008 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor".
7. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Seksioni Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Puke, "Shoqëria "SIMA-COM" Sh.p.k & "ROLAND" Sh.p.k.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Ju faliminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

GJON GJONAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Seksioni I Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 995/prot
13

Pukë, më 30.12.2020

RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE
NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI
PUBLIKE TË BASHKISË PUKE

SHOQERISE "SIMA-COM" SH.P.K S "ROLAND" SH.P.K
PER NDERTIMIN E HEC "GOMSIQE E EPERME"

Bazuar në kërkesën e shoqërisë "SHOQERISE "SIMA-COM" SH.P.K S "ROLAND" SH.P.K PER NDERTIMIN E HEC "GOMSIQE E EPERME" dhe Urdhërin nr.281 datë 17.10.2019 të kryetarit të bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik dhe financiar të sipërfaqes pyjore/kullosore object hec "Gomsiqe e Eperme" grupi I punës I përbërë nga ing Astrit Hyseni , ing Gjin Filipaj dhe Ing Besmir Laci nga data 17.10.2019 deri në datën 30.10.2019 studioi kërkesën e SHOQERISE "SIMA-COM" SH.P.K S "ROLAND" SH.P.K PER NDERTIMIN E HEC "GOMSIQE E EPERME" dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore object I ndertimit te Hec "Gomsiqe e Eperme" Mbështetur ne miratimin paraprak me nr. 502/2 prot date 15.01.2019 per ndertimin e burimit te ri gjenerues te energjise nga ana e Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar shtrihet ngastrat/nëngastra 30/a,112/,110/a,84/c,81a,85/a,79/a,77/,76/,75, bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullosor "Gomsiqe" dhe janë në pronësi/administrim të te Bashkise Puke ne baze të V.K.M. nr 433 date 08.06.2016 Përshkrimi parcelar I sipërfaqes object studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti. Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: ka ndryshime me të dhënat e regjistrit kadastral Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqërisë "SIMA-COM" SH.P.K S "ROLAND" Sh.p.k per ndertimin e Hec "GOMSIQE E EPERME", ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit.

funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve nga kjo sipërfaqe 0.05 ha do të hiqet nga fondi pyjor pasi do të ndërtohet vepra e marrjes 1 + dekantues + Bazën e Hecit ne parcelen nr 30/a te ekonomise pyjore "Gomsiqe" do të hiqet nga fondi pyjor 0.05 ha pasi do të ndërtohet Godina e centralit ne parcelen nr 110/a te ekonomise pyjore "Gomsiqe", do të hiqet nga fondi pyjor 0.05 ha pasi do të ndërtohet vepra e marrjes 2 + dekantusi + bazen ne parcelen nr 112/a te ekonomise pyjore "Gomsiqe" Ndersa nuk ndryshojne kategorin e perdorimit dhe rikthehen ne gjendjen e mepershme me nje gjatesi 3.113 km trase eksistuese qe do te kthehet ne gjendje eksistuese qe perfshihen ne parcelat e meposhme 30/a,112, 110/a bejne pjesë në ekonomin pyjore/kullosor " Gomsiqe" dhe ngastrat/nëngastra 84/c,81/a,85/a,79/a,77,76,75 .bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullosore "Gomsiqe" gjatesi linje elektrike 3.358 km dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016. Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor public janë të mbështetur në V.K.M-ve nr 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Përrregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si mësipër, "SHOQERISE "SIMA-COM" SH.p.k 5 "ROLAND" Sh.p.k kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë Puke dhe likuidimit të tarifës prej 725310 lekë. Në numrin llogarise Bashkia Puke. Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve nr. 391, datë 21.06.2006 "Përpercaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar me VKM-venë 1064, date 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Përpercaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsiston në:

1. **Vlera e përdorimit për linjat gjatësore kanal per shtrirje tubacion në km**
Hapje kanali e shtrirje tubacioni ne shtratin e rruges ekzistuese 3.113 km

Inproduktive 3.113 km x 110.000 lek = 369380 lekë

2.Vlera e përdorimit për linjat

Inproduktive 3.358 km x 110.000 = 342430 leke

Vlera e bimesise pyjore, flores dhe faunes perbehet nga:
3. Volumi drusore l siperfaqes godines plus volume trasese

$$27 \text{ m}^3 \times 500 \text{ leke} = 13500$$

Vlera e drureve te zjarrit 13500 leke

PERPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO EKONOMIK

Ing Astrit HYSENI



Ing Gjin FILIPAJ



Ing Besmir LACI



**MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
GJON GJONAJ**

